

"HYSENBELLIU" SHPK
RRUGA "PANORAMA", PRANË HOTEL PRESTIGE, TIRANË
NIPT J81813004C

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Sot më datë 27.06.2019, ora 10:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k të ndodhur në Rruga "Panorama" Pranë Hotel "Prestige", Njësia Bashkiake Nr. 9 Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k, një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar me NUIS J81813004C (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Në mbledhje është i pranishëm ortaku:

1. Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të kuotave të Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se janë të pranishëm ortakë që përfaqësojnë shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1. Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;**
- 2. Dhënien e miratimit që fitimi i realizuar i shoqërisë për vitin 2018 dhe rezervat e akumuluar të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital;**
- 3. Të ndryshme.**

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar).

Për sa më sipër:



ASAMBLEJA E SHOQËRISË

VENDOSI:

1. Të japë miratimin për raportin e veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar z. Agim Qenani, lindur në Korçë dhe banues në Elbasan, pajisur me Nr. Liçence profesionale 53 nga Instituti i Ekspertëve të Autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018.
2. Të japë miratimin që fitimi i realizuar i shoqërisë për vitin 2018 në vlerën prej 93,215,297 (nëntëdhjetë e tre milion e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë dhe rezervat e akumuluar në vlerën prej 7,451,513 (shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e trembëdhjetë) Lekë të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital.
3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë, Znj. Megi Kulla të depozitojë personalisht apo nëpërmjet një personi të autorizuar këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për efekt të regjistrimit të tij.

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Z. IRFAN HYSENBELLIU

